



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 24 të Ligjit Nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor të datës 19.01.2006 , Udhëzimit Administrativ nr. 41/2007 - Zbritja e tarifave që duhet të paguhen nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 29.06.2022, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

MBI CAKTIMIN E TARIFAVE PËR QËNDRIMIN DITOR TË FËMIJËVE NË QENDRËN PËR EDUKIMIN DHE ARSIMIMIN PARASHKOLLOR NË LIPJAN

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Vendim përcaktohen obligimet e prindërve për pagesën e tarifave, procedura për lirim nga pagesa e këtyre tarifave si dhe zvogëlimet e tarifave për qëndrim ditor të fëmijëve në Qendrën për edukim dhe arsimimin parashkollor në Lipjan.

Neni 2

Kompenzimi për qëndrim ditor

Prindërit, përkatësisht kujdestarët, për vendosjen e fëmijëve për qëndrim ditor në Qendrën për edukim para fillor në Lipjan, në emër të participimit për një fëmijë, për çdo muaj duhet të paguajnë shumën prej **60.00 €**.

Neni 3

Lirimi nga pagesa e tarifave

Lirimi nga pagesat e përcaktuara në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat ligjore .

Neni 4

Zvogëlimi i tarifave

Prindërit përkatësisht kujdestaret e fëmijëve do te paguajnë tarifën e zvogëluar për qëndrimin ditor për më shumë se një fëmijë, s'i vijon:

Për fëmijën e dytë shumë prej 40.00 €.

Për fëmijën e tretë shumë prej 25.00 €.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen e Komunës.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi mbi caktimin e tarifave për qëndrimin ditor të fëmijëve në Qendrën për Edukimin dhe arsimimin parashkollor në Lipjan 15 Nr.610-47675 i datës 29.09.2015.

Nr. 15-610/01-34128

Lipjan, më 29.06.2022

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

